

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BONUM VENTUS DEVELOPMENTS” SH.P.K

NENI 1
FORMIMI

Sot, më datë 09.09.2024 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Bonum Ventus Developments” Sh.p.k themelohet në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”. Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Z. ARBËR SHAHU** i biri i Fuatit dhe Teftes , i datëlindjes 08.05.1985, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në Adresën Rr: “Brigada VIII”, Pallati Nr.19, Hyrja 4, identifikuar me ID me Nr. 032744646 dhe Nr. Personal I50509028T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. **Znj. Andonika Gegprifti**, e bija e Dhimitrit dhe Llambrinit , e datëlindjes 16.07.1949, lindur në Shijak dhe banuese në Tiranë, në Adresën: “Mihal Popi”, Ndertesa Nr.1, Ap.1, Njesia Administrative Nr.5, i identifikuar me ID me Nr. 036819695 dhe Nr. Personal E95716015K; madhere dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Organi administrues i Shoqërisë ka të drejtë të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.

NENI 2
SELIA

Selia e Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar “Bonum Ventus Developments” Sh.p.k është në adresën: **Rr. Mihal Popi, Ndërtesa Nr.1, Ap. Nr.1, Njesia Administrative Nr.5, Tiranë, Shqipëri.** Ortakët mund të vendosin për transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Bonum Ventus Developments” Sh.p.k është e pacaktuar.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “Bonum Ventus Developments” Sh.p.k. do të jetë: Studimin, projektimin, konsulencën, investimin, financimin, shfrytëzimin, administrimin dhe/ose mirëmbajtjen e projekteve publike dhe/ose private në fusha të ndryshme. Kjo përfshin sipërmarrjen zbatuese për realizimin e veprave të ndryshme me fonde publike dhe/ose jopublike, brenda

AKT THEMELIMI
SHOQËRIA “BONUM VENTUS DEVELOPMENTS” SH.P.K

territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Projektet mund të përfshijnë ndërtimin e ndërtesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve dhe nënkalimeve, autostradave, hekurudhave, hidrocentraleve, ujësjellësve, linjave mbitokësore dhe nëntokësore për energjinë dhe telekomunikacionet, si dhe ndërtimin e veprave ujitëse, centraleve, objekteve turistike, ushtarake, kultit, porteve, aeroporteve dhe objekteve industriale. Gjithashtu, përfshihen rikonstrukcionet dhe restaurimet e përgjithshme të veprave të artit, si dhe montimi i konstruksioneve metalike. Çdo ndërtim tjetër që në përfundim përbën send të paluajtshëm sipas nenit 142 të Kodit Civil, për shkak të trupezimit të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me tokën ose ndërtesën ku është vendosur.

Në fushën e energjisë, veprimtaria përfshin prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike nga burime të ndryshme, duke përfshirë energjinë hidro, qomyrin, karburantet dhe energjinë nga burimet e rinovalueshme. Gjithashtu, shoqëria përfshin ndërtimin dhe operimin e stacioneve elektrike, nënstacioneve elektrike, linjave të transmetimit të energjisë dhe strukturave të tjera ndihmëse.

Aktiviteti i shoqërisë shtrihet edhe në ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe impianteve të telekomunikacionit dhe komunikimeve elektronike, përfshirë shërbimet e ndërlidhjes për telefoninë, internetin, radiotelevizionin dhe transmetimet e tjera elektronike. Shoqëria ka gjithashtu për qëllim administrimin, vendosjen dhe përdorimin e impianteve fikse dhe të lëvizshme për këto transmetime.

Shoqëria do të merret me tregtimin dhe import-eksportin e mallrave të gatshme dhe gjysmë të gatshme, me ose pa akcizë, si dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të karburanteve, naftës, gazit natyror dhe nënprodukteve të tyre.

Veprimtaria përfshin gjithashtu operimin dhe menaxhimin e qendrave tregtare dhe ofrimin e shërbimeve të lidhura, përfshirë qiradhënen, ofrimin e shërbimeve bar-restoran, parkim, qendra fitnessi, kënde lojërash për fëmijë, qendra argëtimi, si dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe jo-sportive. Shoqëria mund të ofrojë gjithashtu trajnime, kurse edukative dhe argëtuese, shërbime pastrimi përfshirë lavazhe automjetesh, administrimin e reklamave, kërkime tregu dhe promovimin e shitjeve, si brenda ashtu edhe jashtë qendrave tregtare.

Në fushën e turizmit, shoqëria do të zbatojë projekte për ndërtimin dhe operimin e hoteleve, fshatrave turistike, resorteve dhe qendrave turistike, duke krijuar facilitetet dhe aksesorët e nevojshëm përfunksionimin e tyre.

Shoqëria do të angazhohet edhe në mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit, përfshirë përpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive dhe teknologjike, si dhe përmirësimin e kushteve të mjedisit rrëthues.

AKT THEMELIMI
SHOQËRIA "BONUM VENTUS DEVELOPMENTS" SH.P.K

Shoqëria do të merret me prodhimin dhe tregtimin e materialeve të ndërtimit dhe aksesorëve të ndërtimit, përfshirë konstruksionet metalike, plastike dhe druri, si dhe prodhimin e dyerve, dritareve.

Veprimtaria e shoqërisë do të përfshijë gjithashtu konsulencë teknike, projektim, supervizim dhe menaxhim të projekteve, realizimin e kontratave dhe marrëveshjeve të ndryshme, si dhe administrimin e fondeve dhe investimeve.

Shoqëria do të ofrojë shërbime në fushën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë qiradhëni, administrimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e tyre, si për shoqërinë ashtu edhe për palë të treta.

Në fushën e bujqësisë dhe agro-përpunimit, veprimtaria përfshin grumbullimin, ruajtjen dhe tregtimin e produkteve bujqësore, si dhe mbështetjen e bashkëpunimit me fermerët, kooperativat bujqësore dhe organizmat e tjera të lidhur me bujqësinë, agroindustrinë, agroturizmin dhe energjinë e rinnovueshme.

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

1. Kapitali themeltar i shoqerisë "Bonum Ventus Developments" Sh.p.k. është 100.000 (një qind mijë) Lekë.
2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është ne përputhje me kontributin e tyre, si më poshtë:
 - **Ortaku Arbër Shahu** zotëron një kuotë të barazvlefshme me 50% të kapitalit themeltar.
 - **Ortaku Andonika Gegprifti** zotëron një kuotë të barazvlefshme me 50% të kapitalit themeltar.

Ky kapital është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Kuotat e Ortakëve regjistrohen në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese të shoqërisë "Bonum Ventus Developments" Sh.p.k janë:

1. Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
2. **Z. ARBËR SHAHU** i biri i Fuatit dhe Teftës, i datëlindjes 08.05.1985, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, në Adresën Rr: "Brigada VIII", Pallati Nr.19, Hyrja 4, identifikuar me ID me Nr. 032744646 dhe Nr. Personal I50509028T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

AKT THEMELIMI
SHOQËRIA "BONUM VENTUS DEVELOPMENTS" SH.P.K

NENI 7

Të drejtat dhe detyrat e Asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj shprehen në statut i cili së bashku me aktin e themelimit përbëjnë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

NENI 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

NENI 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore, zgjidhen me Ndërmjetësim me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japid rezultat, atëhere zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me perjegjësi të kufizuar "Bonum Ventus Developments" Sh.p.k në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë. Në këtë ditë shoqëria "Bonum Ventus Developments" Sh.p.k njihet si person juridik.

Ky akt themelimi u hartua në tre ekzemplarë me vlera të njëjta juridike dhe pasi iu lexua themeluesit, u nënshkrua rregullisht prej tij.

ORTAKËT

Z. Arbër SHAHU

Znj. Andonika GEGPRIFTI

AKT THEMELIMI
SHOQËRIA "BONUM VENTUS DEVELOPMENTS" SH.P.K